

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Në Tiranë, sot më datë 31.01.2024, Palët e mëposhtme:

SHITËS:

1. **Z. Robert ÇINA**, shtetas Shqiptar, i biri i Pandeli, lindur më 14.03.1959 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr.personal F90314117B madhor e me zotësi të plotë për të vepruar *(më tej referuar si "Shitësi")*.

Bashkëshortia pëlqimdhënëse:

Znj. Tatjana ÇINA, shtetase shqiptare, e bija e Hamdi, lindur më 10.05.1959, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr.personal F95510109G madhore e me zotësi të plotë për të vepruar

2. **Znj. Monika HAMZARAJ**, shtetase shqiptare, e bija e Pëllumb, lindur më 20.05.1970, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr.personal H05520252J, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Bashkëshorti pëlqimdhënës:

Z. Rasim HAMZARAJ, shtetas shqiptar, i biri i Shamil, lindur më 03.10.1962, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr.personal G21003098O, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar:

BLERËS:

1. Shoqëria **"T-MEDSS" SHPK**, me numër unik të identifikimit të subjektit M11422033V, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar bazuar në të drejtën e shqiptare, me seli në: Rr. "Kahreman Ylli", Nd. 10, Njesia administrative Nr.4, Tiranë,



përfaqësuar nga administratori Sokol Ramizi, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar (më tej referuar si "**Blerësi**").

BAZA LIGJORE:

Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe nenet 9 e vijues të Statutit të Shoqërisë.

DEKLARIME PARAPRAKE

1. Shitësit janë ortakë në shoqërinë "Megapharma" shpk, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61814028F, me seli në Tiranë, në adresën: Tiranë, Farkë, Mjull-Bathore, Rruga e Elbasanit, Nr.4, përballë TEG, shoqëri e ndarë në 2 (dy) kuota dhe me kapital bazë prej ALL 120.000 (njëqind e njëzet mijë lekë) (më tej referuar si "**Shoqëria**"). Secili prej shitësve ka në zotërim 1 (një) kuotë, e cila u jep të drejtën e pjesëmarrjes me 50% (pesëdhjetë përqind) secilit prej tyre në kapitalin bazë të Shoqërisë, me vlerë kapitali prej ALL 60.000 (gjashtëdhjetë mijë lekë).
2. Blerësi është i interesuar që të bëhet zotëruar i një Kuote e cila do të përfaqësojë 30% të kapitalit bazë të shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK. Për këtë qëllim, secili prej Shitësve do të shesë 30% (tridhjetë përqind) të Kuotës së zotëruar prej tij në Shoqëri, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe Blerësi është i interesuar t'i blejë ato, kundrejt çmimit total prej 4,610,000 Euro (katër milion e gjashtëqind e dhjetëmijë euro).
3. Bazuar në nenin 9 të Statutit të shoqërisë secili prej ortakëve deklaron se nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën e parablerjes për 30% (tridhjetë përqind) të Kuotës së ortakut tjetër, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë, dhe janë dakord që kjo pjesë nga kuota e secilit t'i shitet Blerësit sipas kësaj kontrate.
4. Kjo kontratë nuk përfshin truallin dhe objektin në pronësi të shoqërisë, të cilat do të rregullohen me një kontratë të veçantë.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be "P. R."

5. Për shitblerjen e 30% (*tridhjetë përqind*) të Kuotës të secilit Shitës, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (*pesëmbëdhjetë përqind*) të kapitalit të shoqërisë, janë dakord dhe japin pëlqimin edhe bashkëshortët përkatës.
6. Blerësi ka miratuar blerjen e kuotës me Vendimin nr. ___, datë ___ të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacenuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e 30% (*tridhjetë përqind*) të Kuotës, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (*pesëmbëdhjetë përqind*) të kapitalit të shoqërisë, që secili Shitës zotëron në shoqërinë “MEGAPHARMA” SHPK (*më tej referuar si “Kontrata”*), me kushte si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e 30% (*tridhjetë përqind*) të secilës prej Kuotave, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (*pesëmbëdhjetë përqind*) të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale prej ALL 60.000 (*gjashtë dhjetë mijë lekë*) secila, që secili prej Shitësve zotëron në shoqërinë “Megapharma” shpk në favor të Blerësit, kundrejt çmimit total prej EUR 4,610,000 (*katër milionë e gjashtëqind e dhjetëmijë euro*), sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë.
- 2 Objekt i kësaj kontrate nuk janë trualli dhe objekti në pronësi të shoqërisë, të cilat do të rregullohen me një kontratë të veçantë.

Neni 2 Çmimi Dhe Mënyra E Pagesës

- 2.1. Çmimi total që do të paguhet nga Blerësi, për blerjen e 30% (*tridhjetë përqind*) të kuotës të secilit prej Shitësve, e cila përfaqëson pjesëmarrje në 15% (*pesëmbëdhjetë përqind*) të

kapitalit të shoqërisë, do të jetë EUR 4,610,000 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetëmijë euro).

2.2. Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), për blerjen e 30% të Kuotës së zotëruar prej tyre.

2.3. Pagesa për blerjen e kuotave do të paguhet nga Blerësi në favor të secilit prej Shitësve në vlerën EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), në total në shumën prej EUR 4,610,000 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetëmijë euro).

2.4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej 500,000 (pesëqind mijë euro) pjesë të çmimit. Pjesa e mbetur e çmimit, në total 3,610,000 Euro (tre milion e gjashtëqind e dhjetë mijë euro), ose 1,805,000 Euro (një milion e tetëqind e pesë mijë euro) secilit shitës, do të paguhet sipas planit të pagesave bashkëngjitur kësaj Kontrate.

2.5. Nëse Blerësi nuk paguan 3 këste, sipas planit të pagesave, atëherë:

2.5.1. Kjo kontratë konsiderohet e zgjidhur dhe kuotat u kthehen secilit prej ortakëve siç ishin në gjendjen e mëparshme;

2.5.2. Si pasojë e zgjidhjes së kontratës sipas kësaj dispozite, Blerësit kanë të drejtë të mbajnë 1,000,000 (një milion) Euro të paguara në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe një penalitet prej 30% (tridhjetë përqind) të çmimit të paguar deri në atë moment nga Blerësi;

2.5.3. Pjesa tjetër e çmimit të paguar, në masën 70%, do t'i kthehet Blerësit brenda 2 (dy) viteve nga momenti kur Kontrata do të zgjidhet.

2.6. Pagesa e çmimit do të bëhet në llogaritë e Shitësve si më poshtë:

Për Shitësin Robert Çina:

Titullari i llogarisë: Robert Çina ;

Banka: CREDINS Banke ;



Nr.llogarie: 00000129658 ;

IBAN: AL16 2121 1009 0000 0000 0012 9658 .

Për Shitësen Monika Hamzaraj

Titullari i llogarisë: Monika Hamzaraj ;

Banka: CREDINS Banke;

Nr.llogarie: 00000023173

IBAN: AL31 2121 1009 0000 0000 0002 3173 .

Neni 3

Kalimi i Pronësisë mbi Kuotën

- 3.1 Palët bien dakort se pronësia e Blerësit mbi Kuotën kalon menjëherë në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, duke u bërë menjëherë zotërues i 1 (një) kuote, e cila do të përfaqësojë 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë “MEGAPHARMA” SHPK.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate kapitali bazë i shoqërisë “MEGAPHARMA” SHPK do të zotërohet nga 3 ortakë:
- 3.2.1 **Ortaku Robert Çina** do të jetë zotërues i një kuote, e cila përfaqëson 35% (tridhjetë e pesë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë;
- 3.2.2 **Ortakia Monika Hamzaraj** do të jetë zotëruese e një kuote, e cila përfaqëson 35% (tridhjetë e pesë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë;
- 3.2.3 **Ortaku shoqëria “T-Meds” SHPK** do të jetë zotëruese e një kuote, e cila përfaqëson 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit bazë të shoqërisë.
- 3.3 Regjistrimi i Kontratës pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: Qendra Kombëtare e Biznesit) do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi kuotën në momentin e përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, pavarësisht momentit se kur kjo Kontratë regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse.



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Neni 4

Pasojat e Shitjes së Kuotës

- 4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së kuotës, Blerësi do të bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes në 30% (*tridhjetë përqind*) të kapitalit bazë të shoqërisë.
- 4.2 Çdo detyrim ligjore apo fiskal i Shitësve si ortakë apo detyrim i shoqërisë, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate do të mbetet ekskluzivisht i tyre dhe nuk mbartet nga Blerësi dhe as mund të çënojë të drejtat e tij si ortak në shoqëri.
- 4.3 Blerësi zotëron të gjitha të drejtat e lidhura me kuotën nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe e drejta e tij për të përfituar dividend do të ushtrohet nga viti ushtrimor 2024 e në vijim.

Neni 5

Zgjidhja e Kontratës

- 5.1 Palët bien dakort se me nënshkrimin e kësaj kontrate, asnjë nga palët, bashkëshortët e palëve, trashëgimtarët e tyre, apo çdo person që mund t'i kalojnë të drejta mbi kuotën pas nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk ka të drejtë që të tërhiqet nga detyrimet dhe të drejtat që parashikon kjo kontratë.
- 5.2. Kjo kontratë mund të zgjidhet vetëm në rastin e parashikuar në nenin 2.5. të saj.

Neni 6

Garancitë e Palëve

Shitësit garantojnë Blerësin se:

6.1.1. Zotërojnë secili nga 1 (*një*) kuotë në Shoqëri, me vlerë nominale ALL 60.000 (gjashtëdhjetë mijë lekë) secila, të cilat përfaqësojnë secila nga 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të saj bazë. Kuotat në tërësinë e tyre nuk janë subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;

6.1.2. Kuotat nuk janë subjekt i ndonjë barre reale apo juridike.



- 6.1.3. Kanë të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, duke marrë pëlqimin e bashkëshortëve respektivë.
- 6.1.4. Kanë ndërmarrë apo do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate.
- 6.1.5. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitëses dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 6.1.6. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë.

6.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 6.2.1. Blerja e 30% (tridhjetë përqind) të secilës kuotë të Shitësve, e cila do t'i japë të drejtën e mbi një Kuotë e cila përfaqëson në total 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të bazë të Shoqërisë, e zotëruar nga Shitësit është në përputhje me vullnetin e tij;
- 6.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 6.2.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 6.2.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 6.2.5. Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas kontrates është krijuar si pasojë e veprimtarisë së ligjshme.

6.2.6. Blerësi nuk është subjekt i ndonjë procesi penal lidhur me veprimtarinë e tij.



A large, stylized handwritten signature in blue ink.

7

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Cudo".

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "D. I. ...".

Neni 7 Konfidencialiteti

- 7.1. Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.
- 7.2. Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:
- 7.2.1. Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;
 - 7.2.2. Transmetimi bëhet në kuadër të përmbushjes së një detyrimi;
 - 7.2.3. Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (*p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël*);
 - 7.2.4. Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
 - 7.2.5. Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
 - 7.2.6. Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në *domain-in* publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
 - 7.2.7. Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.
- 7.3. Për të shmangur çdo dyshim: regjistrimi i kësaj Kontrate pranë institucioneve përkatëse përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit nuk përbën shkelje të detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 8 Komunikimi ndërmjet palëve



8

- 8.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet *e-mail-it*, në adresat dhe *e-maillet* e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.
- 8.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose *e-mail-et* e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose *e-mail-in*.
- 8.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 6.2 i kësaj Kontrate.

Neni 9 Interpretimi i Kontratës

- 9.1. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 9.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifiku, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

Neni 10 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 10.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.



10.2. Nëse zgjidhja nuk mund të arrihet, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 11 Forca Madhore

11.1. Për qëllim të kësaj kontrate, “Forcë Madhore” nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmytjet ose grevat.

11.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore.

Neni 12 Të Tjera

12.1 Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:

12.1.1 Plan Pagesa për shlyerjen e çmimit.

12.1.2 Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;

12.1.3 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë “MEGAPHARMA” SHPK;

12.1.4 Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë “T-MEDSS” SHPK;

12.1.5 Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “T-MEDSS” SHPK.

12.1.6 Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë “MEGAPHARMA” SHPK për heqjen dorë nga e drejta e parablerjes dhe shitjen e 30% të kuotës së sëchit ortak Blerësit.



12.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim.

12.3 Kjo kontratë përbëhet nga 10 (*dhjetë*) faqe dhe është hartuar në 5 (*pesë*) kopje origjinale, nga një për secilën palë nënshkruese, një për tu arkivuar nga Shoqëria dhe një për tu regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

12.4 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

PALËT:

SHITËSIT:


Z. Robert Çina

Znj. Tatjana Çina




Znj. Monika Hamzaraj



Z. Rasim Hamzaraj






BLERËSIT:


Shoqëria "T-MEDSS" SHPK






Sokol Ramizi






Nr	Date	Kesti	Kryegje e mbetur
0			3,610,000.00
1	Feb-24	60,166.67	3,549,833.33
2	Mar-24	60,166.67	3,489,666.67
3	Apr-24	60,166.67	3,429,500.00
4	May-24	60,166.67	3,369,333.33
5	Jun-24	60,166.67	3,309,166.67
6	Jul-24	60,166.67	3,249,000.00
7	Aug-24	60,166.67	3,188,833.33
8	Sep-24	60,166.67	3,128,666.67
9	Oct-24	60,166.67	3,068,500.00
10	Nov-24	60,166.67	3,008,333.33
11	Dec-24	60,166.67	2,948,166.67
12	Jan-25	60,166.67	2,888,000.00
13	Feb-25	60,166.67	2,827,833.33
14	Mar-25	60,166.67	2,767,666.67
15	Apr-25	60,166.67	2,707,500.00
16	May-25	60,166.67	2,647,333.33
17	Jun-25	60,166.67	2,587,166.67
18	Jul-25	60,166.67	2,527,000.00
19	Aug-25	60,166.67	2,466,833.33
20	Sep-25	60,166.67	2,406,666.67
21	Oct-25	60,166.67	2,346,500.00
22	Nov-25	60,166.67	2,286,333.33
23	Dec-25	60,166.67	2,226,166.67
24	Jan-26	60,166.67	2,166,000.00
25	Feb-26	60,166.67	2,105,833.33
26	Mar-26	60,166.67	2,045,666.67
27	Apr-26	60,166.67	1,985,500.00
28	May-26	60,166.67	1,925,333.33
29	Jun-26	60,166.67	1,865,166.67
30	Jul-26	60,166.67	1,805,000.00
31	Aug-26	60,166.67	1,744,833.33
32	Sep-26	60,166.67	1,684,666.67
33	Oct-26	60,166.67	1,624,500.00
34	Nov-26	60,166.67	1,564,333.33
35	Dec-26	60,166.67	1,504,166.67
36	Jan-27	60,166.67	1,444,000.00
37	Feb-27	60,166.67	1,383,833.33
38	Mar-27	60,166.67	1,323,666.67
39	Apr-27	60,166.67	1,263,500.00
40	May-27	60,166.67	1,203,333.33
41	Jun-27	60,166.67	1,143,166.67
42	Jul-27	60,166.67	1,083,000.00
43	Aug-27	60,166.67	1,022,833.33
44	Sep-27	60,166.67	962,666.67
45	Oct-27	60,166.67	902,500.00



46	Nov-27	60,166.67	842,333.33
47	Dec-27	60,166.67	782,166.67
48	Jan-28	60,166.67	722,000.00
49	Feb-28	60,166.67	661,833.33
50	Mar-28	60,166.67	601,666.67
51	Apr-28	60,166.67	541,500.00
52	May-28	60,166.67	481,333.33
53	Jun-28	60,166.67	421,166.67
54	Jul-28	60,166.67	361,000.00
55	Aug-28	60,166.67	300,833.33
56	Sep-28	60,166.67	240,666.67
57	Oct-28	60,166.67	180,500.00
58	Nov-28	60,166.67	120,333.33
59	Dec-28	60,166.67	60,166.67
60	Jan-29	60,166.67	0.00
Total		3,610,000.00	

RASIM HANONJ
 Jozef Simoni
 Saded Ramifi
 Obaltes Hoxhoraj
 Tatjana Gine





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J61814028F
2. Data e Regjistrimit	01/07/1994
3. Emri i Subjektit	"MEGAPHARMA"
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	16/06/1994
6. Kohëzgjatja	Nga: 16/06/1994
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Farke MJULL BATHORE Rruga e Elbasanit, Mjulle Bathore, Nr.4, perballe TEG
8. Kapitali	120.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Import-eksport,ri-eksport, ruajtje, shperndarje, shitje me shumice e pakice te artikujve farmaceutik dhe parafarmaceutik, produkte ushqimore me origjine shtazore, shtesave ushqimore dhe produkteve bimore, produkteve kozmetike, produkte per mjeksi estetike, bimeve medicinale, barnave narkotike dhe psikotrope, paisjesh mjeksore dhe laboratorike, reagenteve dhe kiteve, paisjeve dhe materialeve laboraterike dentare, te licensuara nga organet e tjera kompetente ne rastet kur kerkohet, detergjent, dezifektant. - Servis dhe mirembajtje paisjesh mjeksore, paisjesh dentare - Dhenie me qera zyrash dhe ambjentesh. Çdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor
10. Administratori/ët	Robert Çina
10.1 Afati i emërimit	Nga: 20/05/2021 Deri: 20/05/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	



REPubLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12. Administratori/ët	Rasim Hamzaraj	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 20/05/2021	Deri: 20/05/2026
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
14. Ortakët	RobertÇina	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Ortakët	MonikaHamzaraj	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
15.4 Komente (nëse ka)		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Farke MJULL BATHORE Mjull Bathore, Rruga e Elbasanit, Objekti Nr. 4, perballe TEG Tirane Tirane TIRANE Motor me targe AR 354 Tirane Tirane TIRANE Makina me targe AA733RH Tirane Farke FARKE Fiat Doblo me targe AA 940 TN Tirane Tirane TIRANE Makina me Targë AA 354 LU Tirane Tirane TIRANE Motorr me targë AJ 160 Tirane Tirane TIRANE Makine me targe AA732RH Tirane Tirane TIRANE TR 5892 N Tirane Tirane TIRANE Makina me targe AA 126 NP Tirane Tirane TIRANE Makine me targe TR 9015 R. Tirane Farke FARKE Mjeti Motorr me targe BA223 Tirane Farke FARKE Fiat Doblo me targe AA 942 TN Tirane Tirane TIRANE Motor me targe AN 472 Tirane Tirane TIRANE Motorr me targë AJ 083 Tirane Tirane TIRANE Automjet me targe AA 837 FX Tirane Tirane TIRANE Motorri me targe AJ 298	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	Tirane Farke FARKE Fiat Doblo me targe AA 423 TN
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: "MEGAPHARMA" E-Mail: m.bego@megapharm.al Telefon: 0682056520 2245060 Të Tjera: Depozitim i vendimit dt.30-06-2009 mbi caktimin e Ekspertes Kontabël Z.Esmeralda Balluku me nr.Liçense 012 dt.10-02-2000 për të bërë zmadhimin e kapitalit.
18. Statusi:	Aktiv

Datë: 31/01/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/01/31 12:05:47 +01:00
J61814028F2024013112053798
2006



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M11422033V	
2. Data e Regjistrimit	22/02/2021	
3. Emri i Subjektit	T-MEDSS	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	19/02/2021	
6. Kohëzgjatja	Nga: 19/02/2021	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia administrative Nr.4, Rruga Kahreman Ylli, Nd.10	
8. Kapitali	10.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Tregtim I aparatave dhe pajisjeve mjekesore , laboratorike dhe spitalore. Tregtim dhe instalim I sistemeve kompjuterike, elektronike dhe pajisjeve te tjera te automatizimit.	
10. Administratori/ët	Sokol Ramizi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 19/02/2021	Deri: 19/02/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	SokolRamizi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	
12.4 Komete (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	E-Mail: sokol.ramizi@gmail.com Telefon: 0672010925
15. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nëse është hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar)

Regjistrimi Fillestar: CN-662134-02-21

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
05/08/2022	Numri i ceshtjes: CN-963495-07-22 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitim i pasqyrave financiare te vitit 2021 <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendimi i ortakut 2021 T- MEDSS.pdf</u> <u>Bilanci t meds 2021.pdf</u> <u>01.PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.xlsx</u> <u>02.PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.xlsx</u>
28/07/2023	Numri i ceshtjes: CN-161146-07-23 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi pasqyrave financiare te vitit 2022 <u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>BilancTMEDS.pdf</u> <u>VendimAsambleTMEDS.pdf</u> <u>PASQYRAEPOZICIONITFINANCIARTMEDS.xlsx</u>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 31/01/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/01/31 13:42:19 +01:00
M11422033V2024013113421072
3006



Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 107

Data / Date 02/02/2024

Midas Reference / Midas Reference Number P240202AF6JOP08

Luka Reference / Luka Reference Number 60118393411

Klienti Urdherues / Ordering Customer T-MEDSS SHPK M11422033V
Adresa / Address NJ AD NR 4 RR KAHREMAN YLLI ND 10
Numri i llogarise / Account Number 0031611175
IBAN AL40202110060000000031611175

Shuma e urdheruar 500,000.00
Monedha EUR
Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment
Pagese pjesore e koutave te Megaph
arma sipas kontrates
.
60118393411

Komisione / Commissions 20.00
Komisione Swift / Swift Commissions
Komisione Priority / Priority Commissions 0.0000
Komisione Our / Our Commissions 0.0000
Komisione Total / Total Commissions

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer ROBERT PANDELI CINA
Adresa / Address TIRANE
Credins Bank

Banka e perfituesit / Beneficiary Bank Credins Bank
Banka Korrespondente / Correspondent Bank EUR10

Numri i llogarise AL16212110090000000000129658
IBAN
Date Valuta / Value Date 02/02/2024

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.



Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 107

Data / Date 07/02/2024

Midas Reference / Midas Reference Number P240207AG1SOP08

Luka Reference / Luka Reference Number 60118637216

Klienti Urdherues / Ordering Customer T-MEDSS SHPK M11422033V
Adresa / Address NJ AD NR 4 RR KAHREMAN YLLI ND 10
Numri i llogarise / Account Number 0031611175
IBAN AL4020211006000000031611175

Shuma e urdheruar 100,000.00

Monedha EUR

Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment Pagese pjesore e koutave te Megaph
arma sipas kontrates

60118637216

Komisione / Commissions 20.00

Komisione Swift / Swift Commissions

Komisione Priority / Priority Commissions 0.0000

Komisione Our / Our Commissions 0.0000

Komisione Total / Total Commissions

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer MONIKA HAMZARAJ

Adresa / Address TIRANE
Credins Bank

Banka e perfituesit / Beneficiary Bank Credins Bank

Banka Korrespondente / Correspondent Bank EUR10

Numri i llogarise AL3121211009000000000023173

IBAN

Date Valuta / Value Date 07/02/2024

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.





Njoftim Debitimi / Debit Advice

Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 107

Data / Date 06/02/2024

Midas Reference / Midas Reference Number P240206AIV70P08

Luka Reference / Luka Reference Number 60118585000

Klienti Urdherues / Ordering Customer T-MEDSS SHPK M11422033V
Adresa / Address NJ AD NR 4 RR KAHREMAN YLLI ND 10
Numri i llogarise / Account Number 0031611175
IBAN AL40202110060000000031611175

Shuma e urdheruar 400,000.00
Monedha EUR
Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment Pagese pjesore e koutave te Megaph
arma sipas kontrates
.
60118585000

Komisione / Commissions 20.00
Komisione Swift / Swift Commissions
Komisione Priority / Priority Commissions 0.0000
Komisione Our / Our Commissions 0.0000
Komisione Total / Total Commissions

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer MONIKA HAMZARAJ
Adresa / Address TIRANE
Credins Bank
Banka e perfituesit / Beneficiary Bank Credins Bank
Banka Korrespondente / Correspondent Bank EUR10
Numri i llogarise AL3121211009000000000023173
IBAN
Date Valuta / Value Date 07/02/2024

Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!

Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.



Vendim
i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve
të shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK


Sot, më 31.01 2024, në selinë e Shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK me NUIS J61814028F u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të saj në praninë e Ortakëve të saj si më poshtë:

1. Robert Cina, ortak me 1 (një) kuotë, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 50% në kapitalin bazë të shoqërisë;
2. Monika Hamzaraj, ortake me 1 (një) kuotë, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 50% në kapitalin bazë të shoqërisë.

ME REND DITE:

1. Miratimin e shitjes së kuotave të zotëruara nga ortakët e shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK, duke hequr dore nga e drejta e parablerjes, në favor të Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK, ku secili prej ortakëve do t'i shesë 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kuotave që zotëron Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK. Kështu Shoqëria "T-MEDSS" SHPK do të bëhet ortake e Shoqërisë "MEGAPGHARMA" SHPK duke zotëruar në përfundim të transaksionit të shitblerjes 30% (tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të saj, kundrejt cmimit total prej EUR 4.610.000,00 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë euro), sipas kushteve të mëposhtme:
 - a. Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), për blerjen e 30% të Kuotës së zotëruar prej tyre.
 - b. Pagesa për blerjen e kuotave do të paguhet nga Blerësi në favor të secilit prej Shitësve në vlerën EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), në total në shumën prej EUR 4,610,000 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë euro).
 - c. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej 500,000 (pesëqind mijë euro) pjesë të çmimit. Pjesa e mbetur e çmimit, në total 3,610,000 Euro (tre milion e gjashtëqind e dhjetë mijë euro), ose 1,805,000 Euro (një milion e tetëqind e pesë mijë euro) secilit shitës, do të paguhet sipas planit të pagesave bashkëngjitur
2. Autorizimin e Z.Rasim Hamzaraj dhe Z. Robert Cina, në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë, që të dorëzojnë apo të autorizojnë persona të tretë për të depozituar në emër të Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të regjistruar këtë vendim, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Bazuar në nenin 81 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe në Statutin e shoqërisë, pasi ortakët e shoqërisë



KONSTATUAN SE:

Duke qenë se sa më sipër është në përputhje me interesat e shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK, planin e biznesit të shoqërive "MEGAPHARMA" SHPK, si dhe me parashikimet ligjore në fuqi, Ortakët e kësaj shoqërie, pas diskutimit të rendit të ditës, unanimisht

VENDOSËN:

1. Të miratojnë shitjen e kuotave të zotëruara nga ortakët e shoqërisë "MEGAPHARMA" SHPK, duke hequr dore nga e drejta e parablerjes në favor të Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK, ku secili prej ortakëve do t'i shesë 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kuotave që zotëron Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK. Kështu Shoqëria "T-MEDSS" SHPK do të bëhet ortakë e Shoqërisë "MEGAPGHARMA" SHPK duke zotëruar në përfundim të transaksionit të shitblerjes 30% (tridhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të saj, kundrejt çmimit total prej EUR 4.610.000,00 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetëmijë euro, sipas kushteve të mëposhtme:


- a. Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), për blerjen e 30% të Kuotës së zotëruar prej tyre.
- b. Pagesa për blerjen e kuotave do të paguhet nga Blerësi në favor të secilit prej Shitësve në vlerën EUR 2,305,000 (dy milionë e treqind e pesë mijë euro), në total në shumën prej EUR 4,610,000 (katër milionë e gjashtëqind e dhjetëmijë euro).
- c. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi do t'i paguajë secilit prej Shitësve shumën prej 500,000 (pesëqind mijë euro) pjesë të çmimit. Pjesa e mbetur e çmimit, në total 3,610,000 Euro (tre milion e gjashtëqind e dhjetë mijë euro), ose 1,805,000 Euro (një milion e tetëqind e pesë mijë euro) secilit shitës, do të paguhet sipas planit të pagesave bashkëngjitur

2. Të autorizojnë Z.Rasim Hamzaraj dhe Z. Robert Cina, në cilësinë e Administratorëve të Shoqërisë, që të dorëzojnë apo të autorizojnë persona të tretë për të depozituar në emër të Shoqërisë çdo dokument të nevojshëm për të regjistruar këtë vendim, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


Ky vendim regjistrohet në regjistrin e vendimeve të shoqërisë dhe hyn në fuqi menjëherë.

ORTAKËT:

Z.Robert Cina



Znj.Monika Hamzaraj



VENDIM

I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "T-MEDSS" SHPK

Sot, më datë 31.01.2024, në selinë e shoqërisë "T-MEDSS" SHPK, me NUIS M11422033V u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, me pjesëmarrjen e Ortakut të Vetëm:

- **Sokol Ramizi**, zotërues i 1 (një) kuote, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.

ME REND DITE:

1. Miratimin e blerjes së 30% (tridhjetë përqind) të kuotës që ortaku Robert Çina zotëron në shoqërinë "MEGAPHARMA" SHPK, e cila përfaqëson 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar në shoqëri.
2. Miratimin e blerjes së 30% (tridhjetë përqind) të kuotës që ortakja Monika Hamzaraj zotëron në shoqërinë "MEGAPHARMA" SHPK, e cila përfaqëson 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar në shoqëri.
3. Autorizimin e Z.Sokol Ramizi, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK, me tagra të plota dhe të pakufizuara për të nënshkruar kontratën e blerjes së kuotës.

Bazuar në nenin 83/2 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ortaku i vetëm i shoqërisë, pas diskutimit të rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë blerjen e 30% (tridhjetë përqind) të kuotës që ortaku Robert Çina zotëron në shoqërinë "MEGAPHARMA" SHPK, e cila përfaqëson 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar në shoqëri.
2. Të miratojë blerjen e 30% (tridhjetë përqind) të kuotës që ortakja Monika Hamzaraj zotëron në shoqërinë "MEGAPHARMA" SHPK, e cila përfaqëson 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar në shoqëri.
3. Të autorizojë Z.Sokol Ramizi, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë "T-MEDSS" SHPK, me tagra të plota dhe të pakufizuara për të nënshkruar kontratën e blerjes së kuotës.

Ky vendim regjistrohet në regjistrin e vendimeve të shoqërisë dhe hyn në fuqi menjëherë.

